

i FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

PROSERINE

Tretësirë për injeksion - 0.5mg / 1 ml
(Neostigmine bromur)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit

- Ruajeni këtë fletëudhëzues! Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë! Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma me ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

- Cfarë është Proserine dhe përse përdoret
- Përpara se të merrni Proserine
- Si ta merrni Proserine
- Efekte anësore të mundshme
- Si ta ruani Proserine
- Informacion i mëtejshëm.

1. ÇFARË ËSHTË Proserine DHE PËRSE PËRDORET

Proserine është një komponim që frenon veprimtarinë e kolinesterazës e në këtë mënyrë i zgjat dhe i intensifikon veprimet fiziologjike të acetilkolinës. Ka të ngjarë që ajo të ketë edhe veprim të drejtpërdrejtë në fjetet e muskujve të skeletit. Veprimet antikolinesterazike të neostigminës janë të prapësueshme. Pas përdorimit parenteral, Proserine jashtëqitet përmes urinës, si në trajtë të pandryshuar, ashtu edhe në trajtë të metabolitëve. Ajo i nënshtrohet hidrolizës nga kolinesteraza dhe po ashtu metabolohet në melçi.

Proserine indikohet:

- në diagnostikimin e Myasthenia gravis;
- në kontrollin simptomatik të Myasthenia gravis;
- si antidot për bllokuesit neuromuskulorë jodopolarizues pas ndërhyrjeve kirurgjikale;
- në parandalimin dhe trajtimin e retensionit urinar pasoperator.

Mjeku juaj mund ta ketë dhënë Proserine për një qëllim tjetër. Pyesni mjekun tuaj nëse doni të dini pse ju është dhënë ky bar.

2. PËRPARA SE TË MERRNI Proserine

Mos merrni Proserine në qoftë se:

- jeni të ndjeshëm (alergjik) ndaj neostigminës;
- keni bllokim mekanik intestinal ose urinar;
- keni peritonit.

Tregoni kujdes të veçantë me Proserine

Pyesni mjekun tuaj përpara se të merrni Proserine. Proserine duhet përdorur me kujdes të posaçëm në të sëmurët me astmë bronkiale, aritmi, bradikardi, ata që së fundmi kanë kaluar infarkt akut miokardi, hipotension, ulçer peptike, vagotoni, epilepsi, hipertiroidizëm, parkinsonizëm, insuficiencë renale dhe në periudhën e shtatzanisë dhe të ushqyerjes së fëmijëve me gjii.

Ky bar duhet përdorur me shumë kujdes tek pacientët, të cilët kohët e fundit i janë nënshtruar kirurgjisë intestinale dhe asaj të fshikëzës së urinës. Neostigmina nuk duhet përdorur gjatë anestezisë me ciklopropan ose halotan; ajo mund të përdoret pas kalimit të anestezisë.

Kur neostigmina jepet me injeksion, duhet të kemi në dispozicion edhe atropinë për të kundërvepruar në rast se ekzagjerohen efektet muskarinike. Atropina mund të jepet edhe përpara ose bashkë me neostigminën për të minimizuar efektet anësore muskarinike, por kjo mund të maskojë simptomat e para të mbidozimit dhe të çojë në krizë kolinergjike.

Marrja e barnave të tjera

Trajtimi i njëkohshëm me barna të tjera mund të ndikojë ose të ndikohet nga Proserine. Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë. Mos harroni të informoni mjekun tuaj për trajtimin me Proserine në qoftë se ju jepet ndonjë bar tjetër gjatë trajtimit.

Barnat me veprim bllokues neuromuskular, siç janë: aminoglikozidikët, klindamicina, kolistina, ciklopropani dhe anestezikët halogjenikë inhalatorë, mund të antagonizojnë efektet e neostigminës.

Barnat si: kinina, klorokina, hidroksiklorokina, kinidina, prokainamidi, propafenoni, litiumi dhe beta-blokuesit, të cilët kanë potencial për të rënduar Myasthenia gravis, mund të reduktojnë efikasitetin e trajtimit me neostigminë.

Antikolinesterazikët, si neostigmina, mund të frenojnë metabolizmin e suksametoniumit dhe të theksojnë dhe të zgjasin veprimin e tij. Nuk rekomandohet përdorimi i kombinuar i tyre. Antimuskarinikët, si atropina, antagonizojnë efektet muskarinike të neostigminës.

Kortikosteroidet mund t'i antagonizojnë antikolines-terazikët në Myasthenia gravis, duke dhënë një deprimim të thellë muskular. Bllokada neuromuskulare e shkaktuar nga suksinilkolina mund të zgjatet ose edhe të antagonizohet nga neostigmina.

Shtatzania dhe Ushqimi me gji

Kërkoni këshillën e mjekut ose të farmacistit përpara se të merrni këtë bar!

Kategoria C.

Ky bar duhet shmangur në shtatzani dhe mund të përdoret vetëm nëse përfitimi i mundshëm e tejkalon riskun ndaj të cilit ekspozohet fetus.

Laktacioni

Neostigmina kalon në sasi të vogla në qumështin e gjirit.

Përdorimi në periudhën e laktacionit duhet të evitohet.

3. SI TA MERRNI Proserine

Gjithmonë merreni Proserine sipas këshillës së mjekut. Në qoftë se nuk jeni i sigurt, kontaktoni me mjekun ose farmacistin. Në qoftë se ndjeni që efektet e Proserine janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj. Injeksionet mund të merren në rrugë intravenoze, intra-muskulare dhe nën lëkurë.

Tretësira për injeksion Proserine disponohet në formëdozën e mëposhtme:

0.5 mg / 1ml.

Proserine mund të përdoret si më poshtë:

në Myasthenia gravis: injektim nën lëkurë ose në muskul;

të rriturit, 1 - 2.5 mg në intervale të përshtatshme (dozë e përgjithshme ditore 5 - 20 mg);

fëmijët, 0.2 - 0.5 mg sipas nevojës;

të porsalindurit, 0.05 - 0.25 mg çdo 4 orë, 30 minuta para ushqyerjes.

si antagonist i bllokadës neuromuskulare

jodopolarizuese:

0.05 - 0.07 mg / kg (maksimumi 5 mg) duke injektuar ngadalë në venë (mbi një minutë) pas ose bashkë me 0.6 – 1.2 mg sulfat atropine.

Në qoftë se keni marrë më shumë Proserine

Në qoftë se keni marrë më shumë Proserine se sasia që duhet të merrnit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.

Në qoftë se keni harruar të merrni Proserine

Në qoftë se harroni një dozë (ose më shumë doza), merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj. Mos merrni një dozë të dyfishtë (ose më të lartë) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a). Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME TË Proserine

Si të gjithë barnat e tjerë, Proserine mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston.

Gjatë terapisë me Proserine mund të manifestohen disa efekte anësore: të përziera, të vjella, shtim i pështymës, diarre, krampe abdominale (më të theksuara kur përdoren doza të larta).

Si shenja të mbidozimit mund të përmenden: shtim i çrregullimeve gastrointestinale, shtim i sekrecioneve bronkiale dhe i djersitjes, defekim dhe urinim i pavullnetshëm, miozë, nistagmus, bradikardi, hipotension, axhitim, dobësi që mund të çojë deri në paralizë.

Si antidot kundër efekteve muskarinike mund të përdoret edhe atropina.

5. SI TA RUANI Proserine

Mbajeni larg fëmijëve!
Mos e përdorni Proserine pas datës së skadencës, e cila është e shënuar në paketim.
Mos e ruani në temperaturë mbi 30°C!
Ruajeni në paketimin original për ta mbrojtur nga drita dhe lagështia!

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Proserine – tretësirë për injeksion

Lënda vepruese është: bromur neostigmine.
Çdo ampulë 1 ml përmban: bromur neostigmine 0.5 mg (0.05 %).



Përbërës të tjerë: ujë për injeksion.


Përmbajtja e paketimit:

Forma e paketimit:
ampulë x 1 ml;
kuti x 10 ampula,
kuti x 100 ampula (Përdorim spitalor).

Shpjegues i ikonave ilustruese për paketim:

 Sipas recetës së mjekut.

 Përmbajtja.  Kujdes.

 Tretësirë për injeksion.

Mbajtësi i autorizimit për tregtim (MAT) dhe prodhuesi:

 **PROFARMA Sh.a.**
Rruga "Myslym Keta"
Tel.Fax: 00 355 4 23 62 800
Tiranë - SHQIPËRI

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në: Dhjetor 2011.

PAY ATTENTION, all the layers are visible.

If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.

 SPECIFICATION

 CROPING AREA 12 x 19 cm